



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 1 qershor 2015  
Nr. ref.: RK 803/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI164/14**

Parashtrues

**Shpëtim Halimi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,  
Rev. nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shpëtim Halimi, nga Livoqi i Ulët, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i cili përfaqësohet nga z. Skënder Zenuni, avokat në Gjilan.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin (Rev. nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për revizion.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se *“janë shkelur të drejtat e parashtruesit, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), më saktësisht neni 24, [Barazia para Ligjit] paragrafi 1 dhe 2, dhe neni 46 [Mbrojtja e Pronës]”*.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) lidhur me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe me rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 6 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 dhjetor 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Judge Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 20 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.
8. Më 13 maj 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Komunale në Gjilan, me të cilën kërkoi t'i konfirmohej e drejta e parablerjes si dhe të anulohesh kontrata e shitjes lidhur me pronën e paluajtshme.
10. Më 27 dhjetor 2005, Gjykata Komunale (Aktvendimi C. nr. 636/2004) konstatoi se padia e parashtruesit ishte tërhequr dhe kështu e mbylli çështjen pa vendosur për meritat e rastit.
11. Parashtruesi nuk kishte parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale.

12. Më 23 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Gjykatën Komunale në Gjilan një kërkesë për përsëritje të procedurës, me pretendimin se “[...] e gjithë procedura është mbështetur në deklaratat e rreme si dhe në dokumente të rreme [...]”.
13. Më 11 dhjetor 2012, Gjykata Komunale (Aktvendimi C. nr. 636/2004) e hodhi poshtë si të palejuar dhe jo të plotë propozimin e parashtruesit për përsëritjen e procedurës, meqenëse “[...] ka kaluar afati subjektiv prej 30 ditësh dhe afati objektiv prej 5 vitesh [...]”. Gjykata Komunale thekson gjithashtu se parashtruesi kërkesës së tij për përsëritjen e procedurës “[...]nuk i ka bashkangjitur asnjë provë për të vërtetuar bazueshmërinë e saj”.
14. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.
15. Më 15 maj 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 4943/2012) e hodhi poshtë si të pabazë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale.
16. Parashtruesi parashtrroi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Komunale.
17. Më 1 shtator 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 223/2014) e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion, duke konfirmuar:

*“[...] në rastin konkret nuk ka përfundim meritore të çështjes kontestuese, nga se procedura kontestimore ka përfunduar me aktvendim me të cilin [nga ana e parashtruesit] është tërhequr padia [...].*

*Për rastet që është paraqitur propozimi për përsëritje të procedurës nga neni 232 pika c) dhe d) të LPK-së [Ligji për Procedurën Kontestimore], afati për paraqitjen e propozimit në kuptim të nenit 234, pika d) dhe e) të LPK-së është 30 ditë nga dita kur propozuesi ka kuptuar për aktgjykimin e formës së prerë. Propozuesi propozimin e ka paraqitur nga kjo bazë juridike, por jo vetëm që propozimit nuk i ka bashkangjitur një aktgjykim të tillë, por në arsyetim të propozimit as që përmendet një aktgjykim i tillë [...]. Procedura, përsëritja e së cilës është kërkuar, ka përfunduar me aktvendimin e plotfuqishëm C. nr. 636/04 të datës 27.12.2005, kurse propozimi për përsëritje të procedurës është paraqitur më datën 24.11.2010”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta, duke hedhur poshtë kërkesën e tij për përsëritje të procedurës, kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, domethënë, të drejtat që lidhen me “barazinë para ligjit dhe mbrojtjen e pronës”.
19. Parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e tij për barazi, e cila garantohet me nenin 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës sepse atij nuk “[...] i është dhënë mundësia e shprehjes para gjyqtarit të çështjes [...]”.

20. Parashtruesi gjithashtu pretendon se i është shkelur e drejta e tij në mbrojtjen e pronës, e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse “[...] gjyqtari i çështjes [...] më ka mohuar të drejtën e babagjyshit në pronën [...]”.
21. Parashtruesi përfundon duke iu drejtuar Gjykatës me deklaratën e mëposhtme:

*“[...] Shpëtim Halimi është i vullnetit të mirë që ky kontest civilo-juridik të përfundojë në atë mënyrë që prona e stërgjyshërve të kthehet te pronari gjegjësisht nipit të tyre, Shpëtim Halimi.*

*Kjo paluajtshmëri është marrë në mënyrë të njëanshme e arbitrare nga gjyqtari i çështjes i cili, sipas thënieve të Shpëtim Halimit, e ka detyruar që të deponojë për tokën e stërgjyshërve [...] DM [Marka Gjermane]. [...]”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuarara me Kushtetutë dhe të specifikuarra më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.

#### **Neni 48 i Ligjit**

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

#### **Rregulli 36 i Rregullores së punës**

*“[...] (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: [...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

24. Gjykata rikujton se parashtruesi konteston Vendimin (Rev. nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014) të Gjykatës Supreme, me pretendimin se me anë të tij i është shkelur e drejta për barazi para ligjit dhe mbrojtje të pronës, të garantuara me Kushtetutë.
25. Në të vërtetë, parashtruesi argumenton në mënyrë të përgjithshme dhe pa iu referuar ndonjë vendimi specifik të gjykatave më të ulëta, se nuk i është dhënë “mundësia për të paraqitur rastin e tij” përpara gjykatave të rregullta dhe se i është shkelur e drejta e pretenduar si “pasardhës” i pasurisë së paluajtshme të stërgjyshit të tij.
26. Gjykata vëren se në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë asnjë arsyetim procedural ose material: ai vetëm pohon pretendimet e lartpërmendura pa shpjeguar më tej se si kanë ndodhur ato shkelje.

27. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Komunale e ka hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit për rihapjen e procedurës, duke vlerësuar se ka kaluar afati për dorëzimin e asaj kërkesë dhe se, përveç kësaj, parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë provë që e mbështet kërkesën e tij.
28. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit e ka arsyetuar vendimin e saj në lidhje me pretendimet e parashtruesit për “*shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkelje të së drejtës materiale*”, duke vërtetuar se Gjykata Komunale e ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale me rastin e hedhjes poshtë të kërkesës së parashtruesit për rihapjen e procedurës.
29. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka hedhur poshtë si të pabazë kërkesën e parashtruesit për revizion, me arsyetimin se: “[...] e pranon në tërësi një qëndrim të tillë të gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me hedhjen si të palejuar të propozimit për përsëritjen e procedurës, pasi që aktvendimet e goditura nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare”.
30. Gjykata vlerëson se procedurat në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe se vendimet janë thellësisht të arsyetuara dhe argumentuara.
31. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është ofruar gjykim i drejtë. (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991; dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
32. Për më tepër, parashtruesi nuk e ka treguar me qartësi si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat është hedhur poshtë kërkesa e tij për përsëritje të procedurës, përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale, të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur prova të cilat arsyetojnë pretendimin për një shkelje të tillë.
33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t’i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
34. Gjykata Kushtetuese përsërit se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta apo autoriteteve të tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta ose autoriteteve të tjera publike, aty ku është e mundshme, t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ], Aktvendim i 21 janarit 1999. Shih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese në Rastin nr. KI70/11, *Parashtrues: Faik Hima, Magbule Hima, dhe Bestar Hima* Aktvendimin për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

35. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, e cila dëshmon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendim i GJEDNJ-së, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk ka treguar se si nenet e Kushtetutës, të cilëve u referohet, e mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe neni 48 i Ligjit.
36. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij për barazi para ligjit dhe për mbrojtje të pasurisë janë të paargumentuara dhe të padëshmuara, dhe për këtë arsye janë qartazi të pabazuara.
37. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (2) (d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani